

PYETJE: «NË QOFTË SE TË GJITHA KISHAT JANË TE MIRA PARA PERËNDISË, Ç'RËNDËSI KA SE NË CILËN PREJ TYRE JEMI ANËTARË?»

PËRGJIGJE: Qëllimi ynë është që të mos e shndërrojmë kishën e themeluar nga Krishti në një sekt fetar. Po pse të shqetësohemi? Në qoftë se grupimet (sektet) fetare janë të njëjta, pse duhet të shqetësohemi nëse jemi anëtar i një sekti?

Qëllimi ynë në këtë kapitull është që t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje duke e bazuar përgjigjen tonë në Bibël.

KRISTANIZMI I PASTËR¹ PËRKUNDËR KRISTIANIZMIT TË INTERPRETUAR NGA NJERËZIT

Në fillim, shikoni shpjegimin e mëposhtëm për kristianizmin e pastër. Le të fillojmë duke dhënë përkufizimin e termave që do përdorim.

Çfarë kuptimi ka fraza «grupime fetare»? Ne e përdorim këtë frazë ashtu si shumica e njerëzve e përdorin atë në kuptimin fetar. Disa nga kuptimet e kësaj fraze janë: «një grup apo sekt fetar»; «një kishë apo sekt që mban një emër të veçantë»; «një organizatë e veçantë fetare»; «një grup fetar që ndjek një besim të caktuar dhe mban një emër të veçantë».

Pra, një ndarje fetare është një *sekt* fetar. *Ajo është një sekt që ka doktrinë të veçantë dhe mban emër të veçantë.* Çdo ndarje fetare ndjek një mënyrë të veçantë nderimi të bazuar në doktrina të ndryshme. Shumica e ndarjeve fetare përfaqësohen dhe kontrollohen nga organizmat e tyre drejtuese.

Ndarja fetare është një sekt me doktrinë të veçantë që bën pjesë në një organizatë më të madhe. Përfaqësuesit e ndarjeve fetare mendojnë se ato të

gjitha janë thjesht pjesë të kristianizmit dhe se të gjitha ndarjet fetare krijojnë një trup të vetëm, trupin e Krishtit.

Çfarë nënkuptojmë kur themi «të mos jesh anëtar i një ndarjeje fetare»? Qëllimi ynë është që të kujtojmë se në fillimet e kishës nuk kishte ndonjë ndarje të besimtarëve kristianë në grupime të veçanta apo sekte të ndara nga njëri-tjetri. Dhe më pas të përpiqemi të kthehemi te modeli i Biblës për kishën. Ne mund të themi se qëllimi ynë është që t'i ngajmë kishës që ekzistonte *përpara* se të krijoheshin ndarjet fetare.

A ka ekzistuar ndonjë periudhë në histori kur besimtarët e Krishtit nuk kanë qenë të ndarë në grupe apo sekte? Po, ka ekzistuar! Në kohët e Testamentit të Ri kishte vetëm një trup (Efesianëve 4:4); ky trup ishte kisha (Efesianëve 1:22, 23; Mateu 16:18; 1 Korintasve 12:20). Pra, në atë kohë nuk kishte ndarje fetare, por kishte vetëm një kishë dhe kjo kishë ishte trupi i Krishtit. Kjo kishë e vetme përfaqësoonte gjithë kristianët kudo që ishin.

Në Testamentin e Ri, situata që më shumë do të na bënte të mendonim për ndarje të besimtarëve në grupe i përket bashkësisë së kristianëve në qytetin e Korinthit:

Sepse më është treguar për ju, o vëllezër, nga ata të shtëpisë së Kloes, se në mes jush ka grindje. Dhe dua të them këtë, që secili nga ju thotë: «Unë jam i Palit», «unë i Apolit», «unë i Kefës» dhe «unë i Krishtit». Vallë i ndarë qenka Krishti? Mos Pali u kryqëzua për ju? Apo ju u pagëzuat në emër të Palit? (1 Korintasve 1:11–13).

Madje edhe në këtë rast ne nuk shikojmë ndonjë ndarje fetare si ajo që gjejmë sot, por shikojmë vetëm fillimet e ndarjes fetare. Madje edhe këto shenja fillestare u kritikuan rëndë! (Galatasve 5:19–21). Në kohët e Testamentit të Ri kishte vetëm një kishë dhe çdo përpjekje për të ndarë kishën në pjesë apo sekte ndëshkohej.

Kështu, *kisha e Testamentit të Ri nuk ishte një ndarje fetare*. Qëllimi ynë është që të bëhemi si ajo kishë! Duke i ngjarë kishës e hershme, ne padyshim nuk do të jemi pjesë e ndonjë grupimi fetar. Meqenëse kisha e Testamentit të Ri nuk ishte grupim fetar, atëherë, kur flasim për grupimet fetare, ne nënkuptojmë ngjarjet që ndodhën pas kohës së apostujve dhe për kishat që u krijuan pas shekullit të parë.

NË MBROJTJE TË KRISTIANIZMIT TË PASTËR

E dyta, shikoni këtë provë në favor të kristianizmit të pastër (jo të përçarë). Pse duhet ta mbrojmë idenë e një kishë të vetme të themeluar nga Krishti dhe të ndërtuar nga apostujt në shekullin e parë?

E para, disa njerëz janë kundër kësaj me pretekstin se është *e pamundur* që t'i rikthehesh kishës së Testamentit të Ri, sepse, sipas tyre, Perëndia nuk ka lënë ndonjë model që do të na udhëhiqte në këtë proces.

Disa thonë se modeli për kishën nuk ekziston dhe pikë. Ata as që duan të dinë më shumë për këtë çështje. Ata nuk besojnë se Perëndia na flet me anë të Biblës dhe se Ai na e ka dhënë modelin e kishës në faqet e saj.

A është ky argument i vërtetë? Jezusi, pasi i urdhëroi apostujt që t'u mësonin të tjerëve ato që ata kishin mësuar prej Tij, tha: «Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës» (Mateu 28:20). A do të thotë kjo se Jezusi shpresonte që apostujt të ndryshonin mësimet e Tij? Te Juda 3 lexojmë «për besimin që u qe trasmetuar shenjtorëve një herë e përgjithmonë». A tingëllon kjo sikur modeli i Testamentit të Ri ishte vetëm për ata që jetuan gjatë shekullit të parë? Pali tha se madje edhe nëse një engjëll predikon një ungjill ndryshe nga ungjilli që Pali predikoi, atëherë ai engjëll do të ndëshkohet (Galatasve 1:8). A ishin mësimet e Jezusit një model që ishte thjesht i përkohshëm?

Në qoftë se qëllimi i Testamentit të Ri është që të shërbejë si udhëzues për të gjithë njerëzit «deri në

fund të kohës», atëherë ne duhet të besojmë se qëllimi i kishës së Testamentit të Ri ishte që të bëhej model për kishën «deri në fund të kohës». Apostujt u udhëhoqën në gjithçka nga e vërteta (Gjoni 16:13) dhe kisha e Perëndisë u krijua si rezultat i ungjillit që ata predikuan. Kjo kishë mësoi dhe praktikoi doktrinat e dhëna nga apostujt e frymëzuar. Ne lexojmë për këtë kishë të hershme në Testamentin e Ri. Po në Testamentin e Ri ne lexojmë për mësimet që kjo kishë ndiqte, për mënyrën se si e nderonte Perëndinë dhe për organizimin e saj. Në qoftë se ishte Krishti ai që e themeloi Kishën dhe na bëri të njohur vullnetin e Tij lidhur me të, a nuk ishte qëllimi i Tij të krijonte një model të kësaj kishë për brezat që do të vinin?

Ne besojmë se Kisha që themeloi Krishti është modeli i kishës që Ai vetë projektoi për të gjitha kohërat. Kjo kishë do të jetë e pranueshme përpara Perëndisë përderisa ajo ndjek modelin e dhënë nëpërmjet apostujve në faqet e Biblës. *Mund të jemi të sigurt* se bëjmë vullnetin e Perëndisë vetëm kur ndjekim modelin e dhënë prej Tij në Bibël.

Disa kundërshtojnë dhe thonë se në kohët e Testamentit të Ri *nuk kishte ndonjë model veçantë* për kishën. Unë mbaj mend kur takova një predikues dhe u përpoqa t'i shpjegoja kthimin te kisha e Testamentit të Ri. Ai u përgjigj: «Kështu, ti dëshiron të restaurosh kishën e Testamentit të Ri? Por *cilën* kishë? A do të restaurosh kishën në Jeruzalem, Antioki, Efes apo atë në Korint?» Ai besonte se bashkësitë e Testamentit të Ri ishin kaq të ndryshme nga njëra-tjetra sa që në to nuk mund të gjejmë një model të vetëm sipas të cilit të mund të restaurojmë kishën sot. A qëndron ky argument?

Po, kishte ndryshime midis bashkësive të shekullit të parë, bashkësi për të cilat flitet në Testamentin e Ri. Por gjithë ndryshimet e tyre vinin nga dy burime. Disa ndryshime vinin nga fakti se këto bashkësi ishin të ndryshme si nga zona gjeografike ku ndodheshin ashtu edhe nga përbërja e tyre. Kështu për shembull, nëse anëtarët e një bashkësie nuk mund të mblidheshin gjatë orëve të ditës për shkak të përndjekjes që u bëhej kristianëve dhe, si rezultat, ata mblidheshin gjatë orëve të para të agimit apo natën vonë, kjo nuk do të thotë që anëtarët e një bashkësie tjetër të vendosur në një zonë ku përndjekja nuk ishte aq e madhe duhet të mblidheshin në të njëjtin orar si edhe bashkësia e parë. Nga ana tjetër, disa nga ndryshimet e tjera

vinin si rezultat i mosrespektimit të mësimit të apostujve. Kisha e themeluar nga Krishti ishte e përkryer, por ishte e përbërë nga njerëz jo të përkryer. Ne duam t'i kthehemi këtij modeli të përkryer të kishës dhe jo gabimeve të anëtarëve të saj, që ishin njerëz jo të përkryer si të gjithë ne.

Akoma më shumë, evidenca tregon se, *në vendet ku mësimit e apostujve ishin pjesë thelbësore e besimit të kishës*, bashkësitë e kishës së Perëndisë ishin të njëjta. Pleqtë ishin zgjedhur në çdo bashkësi (Veprat 14:23), ata këndonin gjatë nderimit të Perëndisë (Efesianëve 5:19; Kolosianëve 3:17), merrnin Darkën e Zotit (Veprat 2:42; Veprat 20:7; 1 Korintasve 11), jepnin sipas të ardhurave të tyre (1 Korintasve 16:1, 2), praktikonin pagëzimin me anë të zhytjes (Veprave 8:39; Romakëve 6:3, 4; Kolosianëve 2:12), të gjithë ishin shpëtuar në të njëjtën mënyrë (Veprat 15:9, 11), letrat e frymëzuara që i dërgoheshin një bashkësie lexoheshin përpara të gjithë besimtarëve (Kolosianëve 4:16). Në fakt, Pali shkroi: «Për këtë arsye ju kam dërguar Timoteun, që është biri im i dashur dhe besnik në Perëndinë. Ky do t'ju kujtojë udhët e mia në Krishtin ashtu siç mësoj kudo në çdo kishë» (1 Korintasve 4:17). Atëherë si mundet të thotë ndonjëri se bashkësitë e kishës së Perëndisë në Testamentin e Ri ishin kaq të ndryshme sa që nuk mund të gjejmë ndër to një model të vetëm për kishën sot?

E dyta, njerëz të tjerë thonë se restaurimi i kishës së Testamentit të Ri *nuk është i nevojshëm*, sepse të gjitha grupet kristiane sot në botë janë pjesë e një kisha të vetme.

A qëndron ky argument? A janë bashkësitë e shumta pjesë e një kisha të vetme? Ato mund të jenë pjesë të grupimeve fetare apo pjesë të protestantizmit, por ne dëshojmë se ato janë pjesë e asaj kisha për të cilën lexojmë në Testamentin e Ri. Vetëm një herë lexojmë për «degët» në Testamentin e Ri. Krishti thotë: «Unë jam hardhia, ju jeni shermendet» (Gjoni 15:5). Por ai më tej thotë: «Në qoftë se ndokush nuk qëndron në mua, hidhet jashtë si shermendi dhe thahet; pastaj i mblidhni, i hedhin në zjarr dhe digjen» (Gjoni 15:6). Degët për të cilat flet Krishti në këto vargje nuk janë sektet apo grupet e ndryshme kristiane. Ato përfaqësojnë çdo besimtar, anëtar të kishës së themeluar nga Krishti.

A keni parë ndonjëherë që nga degët e hardhisë të dalin portokalle, nga një tjetër të dalin mollë dhe nga një tjetër shalqinj? Natyrisht jo! Vreshti prodhon

në çdo degë të njëjtin frut. Por grupet fetare nuk po prodhojnë të njëjtin frut! Rezultatet e tyre janë po aq të ndryshme sa janë edhe portokallet nga mollët apo shalqinjët. Pra, si rrjedhim ato nuk janë degë të kishës së Testamentit të Ri, por, në fakt, secila është një hardhi më vete.

E treta, të tjerë kundërshtojnë duke thënë se *nuk është praktike* t'i kthehemi kishës së Testamentit të Ri sot.

Disa mendojnë se restaurimi i kishës së Testamentit të Ri do të kishte vetëm një rezultat, krijimin e një grupi apo sekti tjetër fetar.

Ata mendojnë se një sekt apo grupim dallohet nga një tjetër vetëm nga emri që ai mbart. Sipas tyre çdo bashkësi që mbart një emër të caktuar është një sekt dhe asgjë më shumë. A mund të quhemi sekt vetëm se kemi një emër.

Ju lutem, vëreni që nuk pretendojmë se emri që ne mbartim është i vetmi emër i përshtatshëm dhe të gjithë emrat e tjerë, të përdorur nga të tjerët, janë të papërshtatshëm. «Kisha», «trupit» apo «kisha e Krishtit» nuk janë në të vërtetë emra, por janë tregues të një marrëdhënieje. Është kisha ajo që i përket Krishtit. Të gjitha këto janë shprehje të gjetura në Testamentin e Ri. Me fjalë të tjera, në qoftë se një *emër* është gjithçka që duhet për të krijuar një grupim fetar, atëherë kisha e Testamentit të Ri ishte një grupim fetar.

Por emri nuk është gjithçka që karakterizon një grupim fetar. Grupimet fetare mbartin emra të veçantë për arsye të diferencave që ato kanë mes njëra-tjetrës. Në qoftë se emrat do të ishin dallimet e vetme midis kishave, atëherë nuk do të kishte ndonjë grupim fetar. Të gjitha grupimet do të ishin të bashkuara në një të vetëm! Një kishë nuk është grupim fetar vetëm për shkak se ka një emër!

Disa thonë se një kishë është grupim fetar, sepse ekziston më vete, sepse beson dhe praktikon të njëjtën gjë pavarësisht nëse është e shkruar apo e pashkruar. Po të përdorim këtë përkufizim, kisha e Testamentit të Ri do të ishte një grupim fetar! Dhe asnjë njeri nuk beson se ajo ishte e tillë. Një kishë nuk mund të quhet sekt vetëm për shkak se është e ndarë nga grupet e tjera si dhe për shkak se mësimit e praktikën e saj janë të ndryshme nga ato të grupimeve të tjera.

Disa e sulmojnë rikthimin te kisha e Testamentit të Ri duke thënë se kjo krijon ndarje të mëtejshme fetare midis njerëzve. Ata thonë se duke sjellë një

kishë *tjetër* në skenë, në vend që të punojmë për bashkimin e gjithë besimtarëve në një, ne krijojmë edhe më shumë përçarje.

Kjo duket sikur përmban diçka të vërtetë. Përpjekjet tona për të restauruar kishën, mund të krijojnë një kishë tjetër dhe, nga këndvështrimi i një njeriu jashtë kishë, kjo kishë mund të jetë një grupim tjetër fetar.

Por, pamja e jashtme mund të na gënjejë. Pse nuk përpiqemi ta sjellim kishën Testamentit të Ri duke qëndruar brenda grupeve që sot ekzistojnë? Kjo pyetje e ka marrë përgjigjen e saj shumë kohë më parë. Në fazat e hershme të lëvizjes reformuese, udhëheqësit e lëvizjes vendosën që të mbeteshin pjesë e grupimeve fetare me shpresën që t'i ndihmonin ato për të kuptuar gabimin e të qenit të ndarë. Më në fund, ata u ndanë nga grupimet fetare dhe filluan të takohen më vete. Pse? *Sepse u detyruan të braktisnin grupimet pjesë e të cilave ata ishin më parë!* Grupimet fetare nuk donin të dëgjonin për kishën e Testamentit të Ri. Ata nuk i lejuan njerëzit që donin të ndiqnin Testamentin e Ri të flisnin para kishës. Si rregull, grupimet fetare që nga ajo kohë e kanë ndaluar predikimin modelit të kishës që Perëndia na e ka dhënë me anë të Biblës.

Me fjalë të tjera, arsyeja e vetme që kërkesa për kristianizëm të pastër duket sikur sjell përçarje vjen nga fakti se disa nuk duan të heqin dorë nga pozitat e privileguara që ata kanë në grupimet e tyre fetare dhe, si rrjedhim, është e pamundur që rikthimi te kisha e Testamentit të Ri të bëhet nëpërmje tyre.

Tani le të shikojmë një *argument të thjeshtë që mbron* rikthimin te kisha e Testamentit të Ri.

A është e mundur që të kthehemi te kisha e parë sot? Mendoni rreth këtij pohimi: *Në qoftë se ne, për t'u bërë kristianë dhe për të qenë kristianë, bëjmë atë që bënë kristianët e shekullit të parë, atëherë i jemi rikthyer kishës së përshkruar në Testamentin e Ri.* A nuk është e qartë kjo? Gjatë periudhës së kohës që Testamenti i Ri përshkruan, njerëzit bënë gjëra të caktuara për t'u bërë kristianë dhe më pas jetuan, nderuan dhe formuan bashkësitë e tyre sipas një mënyre të caktuar. Në qoftë se bëjmë të njëjtat gjëra që ata bënë në këto raste, ne do të bëhemi si ata, thjesht kristianë të Testamentit të Ri, anëtarë të kishës që ndjek këtë Testament.

Problemi është se kristianizmi është kaq i influencuar nga përçarja, sa që kjo përçarje është shndërruar në sinonim të tij për shumë njerëz në botë. Përpiquni ta imagjinoni fenë kristiane të çliruar nga ndarjet dhe grupimet fetare:

Imagjinoni sikur tre grupe fetare vendosin të kenë një takim «të përbashkët». Ata gjejnë vendin e takimit dhe ftojnë një predikues. Me qëllim që të kënaqnin çdo njeri, ata bien dakord që predikuesi të predikojë të njëjtat gjëra që Pali tha gjatë ditës së Rrëshajëve te Veprat 2 dhe në fund ata do të lënë besimtarët të zgjedhin kishën të cilës ata duan t'i bashkangjiten.

Takimi bëhet. Predikuesi predikon Krishtin. Njerëzit besojnë në Krisht dhe ndërgjegjësohen për mëkatet e tyre. Predikuesi, ashtu si Pjetri, u thotë atyre: «Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë» (Veprat 2:38). Atëherë, ashtu si njerëzit bënë në ditën e Rrëshajëve, ata që e morën fjalën me gëzim u pagëzuan. Takimi përfundon dhe 200 veta pagëzohen.

Më pas, të dyqind të pagëzuarve u jepet mundësia të anëtarësohen në njërën prej tre kishave. Pesëdhjetë të pagëzuar i bashkangjiten kishës A, pesëdhjetë të tjerë i bashkohen kishës B dhe pesëdhjetë të tjerë bashkohen me kishën C. Por pesëdhjetë të tjerët thonë: «Pse duhet t'u bashkohemi grupeve fetare? Ne u pagëzuan si njerëzit në kohët e Testamentit të Ri dhe do të vazhdojmë të ecim në gjurmët e tyre.» Kështu, këta pesëdhjetë njerëzit e fundit organizohen në një kishë si ajo e Testamentit të Ri.

Lindin dy pyetje. E para, cilës kishë iu bashkangjiten këta pesëdhjetë njerëz? Në qoftë se ata filluan jetën kristiane sipas modelit të Testamentit të Ri dhe vazhdojnë ta ndjekin atë model më pas, cilës kishë do t'i ngjasojnë ata përveçse asaj të Testamentit të Ri? E dyta, këta dyqind vetë që u pagëzuan, duke menduar se, në të vërtetë, iu bindën ungjillit, anëtarë të cilit grupim fetar ishin *përpara* se të vendosnin t'i bashkangjiteshin njërit prej tre grupeve? Në qoftë se nuk ishin anëtarë të ndonjë grupimi fetar, atëherë pse ishte e nevojshme që t'i bashkangjiteshin *ndonjë* grupimi fetar? A nuk është e mundur që të shpëtohen dhe të bëhen anëtarë të kishës së Perëndisë pa u bërë anëtarë të ndonjë grupimi fetar?

Ne me të vërtetë besojmë se, në qoftë se njerëzit sot bëjnë të njëjtat gjëra që bënë njerëzit në kohët e Testamentit të Ri për t'u bërë kristianë dhe për të jetuar si të tillë, ata do të bëhen ashtu si ata njerëz në kohët e Testamentit të Ri. Ne do të jemi thjesht kristianë dhe anëtarë të kishës të Testamentit të Ri që ndjek kristianizmin e vërtetë.

Pasi kemi përkufizuar dhe mbrojtur qëllimin tonë, jemi gati t'i përgjigjemi pyetjes: *Në qoftë se kishat apo grupimet fetare janë të njëjta, atëherë ç' rëndësi ka fakti se në cilën prej tyre je anëtar?*

THIRRJE PËR TË NDJEKUR KRISTIANIZMIN E PASTËR

Më në fund, konsideroni këtë thirrje për të ndjekur kristianizmin e pastër. A ka ndonjë arsye të mirë për të ndjekur kristianizmin e vërtetë? Do t'i kthehemi titullit të këtij mësimi dhe do t'i japim përgjigjen: Ju lutem që të mos i bashkangjiteni ndonjë grupimi fetar, sepse një kishë *nuk* është po aq e mirë sa edhe një tjetër.

Ju lutem, mos më keqkuptoni. Nuk po them se një grupim nuk është po aq i mirë sa një tjetër. Por se asnjë grupim nuk është po aq i mirë sa kisha e Perëndisë. Në qoftë se ekziston një grupim që është po aq i mirë sa kisha e Perëndisë, atëherë duhet ta pranojmë titullin e këtij mësimi dhe të themi se *nuk* ka ndonjë arsye për të ndjekur kristianizmin e pastër.

Ndërsa shtrojmë pyetjen, nëse një grupim fetar është po aq i mirë sa kisha e Testamentit të Ri, mendoni për këto pyetje:

A është një trup po aq i mirë sa një tjetër? Trupi juaj ka rëndësi më shumë se ndonjë trup tjetër. Në të njëjtën mënyrë, kisha është trupi i Krishtit (Efesianëve 1:22, 23). A është ndonjë trup tjetër (një bashkësi që nuk u krijua nga Krishti) po aq i rëndësishëm për Krishtin sa vetë trupi i Tij?

A është një nuse po aq e mirë sa një tjetër? Burra, a i vlerësoni ju nuset e tjera po aq shumë sa nusen tuaj? Unë s'mendoj kështu! Kisha, gjithashtu, është përshkruar si nusja e Krishtit (Efesianëve 5:23–25; Romakëve 7:4). A vlerëson Krishti ndonjë kishë tjetër po aq shumë sa vlerëson nusen e Tij?

A është një familje po aq e mirë sa një tjetër? Ne kemi një ndjenjë të veçantë për familjen tonë; nuk

do ta ndërronim atë me asnjë familje tjetër. Kisha është familja e Perëndisë (1 Timoteut 3:15). A do të vlerësonte Perëndia ndonjë familje tjetër po aq shumë sa vlerëson familjen e Tij?

A mund të gjendet shpëtimi në ndonjë ndarje fetare? Shpëtimi gjendet te kisha. Krishti, nga dashuria që kishte për kishën, vdiq për ta shpëtuar atë (Efesianëve 5:23–25). Të shpëtuarit i bashkangjiten kishës (Veprat 2:47). A mund të thuhet kjo për ndonjë grupim fetar?

KONKLUZIONI

Në çfarë përfundimi duhet të arrijmë? Një grupim fetar mund të jetë po aq i mirë sa edhe një tjetër, por asnjë grupim fetar nuk është po aq i mirë sa kisha e Perëndisë. Si rrjedhim, ju lutemi që ta pranoni thirrjen për të ndjekur kristianizmin e pastër, sepse besojmë se kjo është rruga e vetme për t'u siguruar se jeni pjesë e trupit të Krishtit, nusja e Krishtit dhe familja e Perëndisë. Vetëm kështu mund të siguroheni se jeni ndër ata njerëz të cilët Krishti i shpëtoi.

A keni menduar ndonjëherë që të ndryshoni kishën pjesë e të cilës jeni? Shumë njerëz nuk janë besnikë ndaj ndonjë grupimi fetar dhe i ndërrojnë kishat me shumë lehtësi. Cilat janë kriteret që përdorni për të zgjedhur një kishë tjetër?

Mendojmë se nuk është gjë e mirë që të kaloni nga një grupim fetar në një tjetër. Përpara se të ndryshoni, duhet të bazoheni në atë që është e drejtë dhe të pyesni: Çfarë dëshiron Perëndia për mua? Midis kishave të shumta, cila është kisha e Tij? Mos u nisni nga parimi: «Shkoj në atë kishë, sepse atje më vjen më mbarë të shkoj.» Zgjidhni atë kishë që Krishti krijoi!

Po ju bëjmë thirrje të ndiqni kishën e Krishtit, atë kishë për të cilën lexoni në Testamentin e Ri. Jemi të sigurt se një njeri pa paragjykime nuk do të ketë asgjë kundër kësaj kishë. Nuk ka asnjë arsye për të mos u menduar rreth kësaj thirrjeje.

SHËNIME

¹ «Kristianizëm i pastër» nënkupton kristianizëm që nuk është ndarë në grupime të ndryshme fetare, por është thjesht kristianizmi që buron nga Bibla.

«Natyrishet është shumë herë më mirë të qorto-

hemi nga ata që na duan dhe të përfitojmë nga qortimi, se sa të banojmë në parajsën e budallait, duke imagjinuar më kot se puna jonë është e dobishme, në një kohë kur askush s'na dëgjon apo

kupton atë që themi. “Besnike janë plagët e një shoku” (Fjalët e Urta 27:6).»

Alfred P. Gibbs
Një Manual për Predikimin

Autor: *Coy Roper*
Marrë nga studimi: “*Pyetje lidhur me besimin te Perëndia*”
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara